URDHËR
Nr. 574, datë 9.6.2025

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË VEGJËL

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, të shkronjës "b", të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminatëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panaire dhe grumbullime të tjera.
2. Ndalimi i lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuar në fermën e prekur nga sëmundja.
3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël.
4. Forcimin e masave të biosigurisë.
5. Kafshët e llojit të imëta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluara nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.
6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privatë dhe shërbimit veterinar shtetëror.
7. Masat e sipërcituara nga pika 1 deri në pikën 6 zbatohen në territorin e:

Nr.	RRETHI	NJËSIA ADMINISTRATIVE	FSHATI
		3 km	
1	Dibër	Martanesh	Ndërfushas
2	Dibër	Martanesh	Melcu
3	Dibër	Martanesh	Val
		10 km	
4	Tiranë	Shëngjergj	Shëngjergj
5	Tiranë	Shëngjergj	Bizë
6	Dibër	Martanesh	Ballenj
7	Dibër	Martanesh	Lenë
8	Dibër	Martanesh	Peshk
9	Dibër	Martanesh	Gjon
10	Dibër	Martanesh	Krastë
11	Dibër	Martanesh	Stavec
12	Dibër	Klos	Plani bardhë
13	Dibër	Klos	Shëngjun
14	Dibër	Klos	Klos katund
15	Dibër	Klos	Fshat
16	Dibër	Xibër	Petralbë

8. Intensifikimin e kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar të Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj